

Fillimviti 2012, përpunohen anije me mallra, si dhe tragete me udhëtarë e automjete

05 Janar 2012



Katër anije me rreth 6 mijë ton mallra dhe 267 kontejnerë po shkarkohen sot në portin detar të Durrësit, ndërkohë që në radën detare pranë tij presin radhën e përpunimit katër anije të tjera me rreth 11 mijë ton mallra gjithsej.

Sipas burimeve zyrtare nga drejtoria e Autoritetit portual, pas ditëve të qeta të fillimvitet vazhdon procesi i shkarkimit për anijet “Frojdi II” dhe “Matyushenko” me përkatësisht 1485 ton pleh me paleta si dhe 5 mijë ton grurë.

Anija e specializuar “Medazov Rosa” po ngarkon 267 kontejnerë me mallra të ndryshme, porosi e grosistëve të huaj për mallra “made in Albania”, ndërsa nga anija “Emine H.” Po shkarkohen 1.033 ton hekur.

Sipas të njejtave burime, në radën e portit detar presin radhën e ankorimit në kalatat përkatëse edhe anija “Oceanic”, e cila pasi ka shkaruar 2.100 ton skrap hekurishte në kalatën 11 do të ngarkojë 2500 prokate çeliku, të prodhuara në fabrikën “Kurum” të Elbasanit.

Anijet tregtare “Volgobalt 220” dhe “Kizhi” do të shkarkojnë në automjete dhe në silosët e kalatës 5 afro 6300 ton grurë gjithsej, porosi e grosistëve shqiptarë të miellit.

Gjatë dy ditëve në vazhdim në portin detar do të mbërrijnë shtatë anije të tjera, katër nga të cilat do të shkarkojnë 1.067 kontejnerë gjithsej, dy anije do të sjellin 9 mijë ton grurë dhe një tjetër do të shkarkojë 3700 ton qymyr.

Përveç përpunimit të mallrave, gjatë këtyre ditëve traqet që nisen nga Durrësi drejt porteve të Barit, Ankonës dhe Triestes (Itali) po transportojnë mesatarisht 1000 automjete dhe 3000 udhëtarë, shumica bashkëatdhetarë që rikthehen pas pushimeve në vendet e Evropës perëndimore ku jetojnë dhe punojnë prej vitesh.

